

VENDIM
Nr. 447, datë 19.6.2026

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, ME VENDNDODHJE NË FSHATRAT DRIZË, GJERGJOVINË DHE CINGAR I POSHTËM, NJËSIA ADMINISTRATIVE PISHAJ, BASHKIA GRAMSH, QARKU ELBASAN, NGA SHOQËRIA “ONE SOLAR” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në zonat kadastrale 1556, 1736 dhe 3262, në fshatrat Drizë, Gjergjovinë dhe Cingar i Poshtëm, Njësia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan, nga shoqëria “One Solar” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) emri i aplikuesit: shoqëria “One Solar” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: M41505052R;
- c) tipi i centralit: fotovoltaik;
- ç) kapaciteti i instaluar: 11.5 mw;
- d) afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonat kadastrale 1556, 1736 dhe 3262, në fshatrat: Drizë, Gjergjovinë dhe Cingar i Poshtëm, Njësia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan;

- e) afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) koordinatat e tokës dhe planvendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) shoqëria “One Solar” sh.p.k. ka detyrimin, që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “One Solar” sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “One Solar” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

ANEKS 1

CENTRALI GJENERUES I ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE
VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, ME
VENDNDODHJE NË FSHATRRAT DRIZË, GJERGJOVINË DHE CINGAR I POSHTËM,
NJËSIA ADMINISTRATIVE PISHAJ, BASHKIA GRAMSH, QARKU ELBASAN, NGA
SHOQËRIA “ONE SOLAR” SHPK

KOORDINATAT NË KRGJSH “ONE SOLAR PARK” 11.5 mw					
Nr.	E	N	NR	E	N
1	511753.551	4533756.911	28	511721.194	4532827.947
2	511767.597	4533655.69	29	511696.473	4532813.062
3	511803.568	4533611.135	30	511650.575	4532788.292
4	511834.479	4533607.577	31	511617.257	4532789.357
5	511855.636	4533578.1	32	511584.723	4532844.753
6	511845.046	4533568.168	33	511559.511	4532845.178
7	511838.828	4533539.777	34	511505.929	4532771.932
8	511897.35	4533470.762	35	511456.883	4532790.717
9	511879.354	4533424.772	36	511449.385	4532821.462
10	511857.894	4533461.708	37	511492.987	4532877.977
11	511826.382	4533462.995	38	511503.909	4532905.886
12	511808.886	4533455.409	39	511497.597	4532945.439
13	511782.946	4533450.001	40	511511.352	4532973.61
14	511782.946	4533477.078	41	511602.027	4533038.857
15	511774.943	4533514.76	42	511611.461	4533100.85
16	511765.908	4533537.005	43	511636.975	4533135.594
17	511755.91	4533585.329	44	511647.985	4533167.508
18	511738.799	4533663.86	45	511629.51	4533194.304
19	511732.94	4533333.042	46	511587.14	4533181.706
20	511710.797	4533284.875	47	511543.721	4533199.739
21	511709.837	4533261.966	48	511525.124	4533235.932
22	511730.205	4533215.637	49	511525.131	4533277.753
23	511729.493	4533162.204	50	511540.397	4533314.445
24	511748.032	4533083.507	51	511585.857	4533304.139
25	511756.67	4532969.036	52	511629.941	4533311.697
26	511773.45	4532932.03	53	511651.63	4533336.535
27	511776.984	4532883.636	54	511675.962	4533348.335

